

KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT RACIAL

*Miratuar dhe hapur për nënshkrim e ratifikim nga Asambleja e Përgjithshme me
Rezolutën e saj 2106 A (XX) të datës 21 dhjetor 1965.*

HYRË NË FUQI: më 4 janar 1969,
në përputhje me nenin 19

Shtetet palë të kësaj Konvente,

Duke marrë parasysh se Karta e Kombeve të Bashkuara mbështetet në parimet e dinjitetit dhe të barazisë së të gjithë njerëzve, dhe se të gjitha shtetet anëtare janë zotuar të veprojnë, si bashkërisht ashtu edhe ndaras, në bashkëpunim me Organizatën, për të realizuar një nga objektivat e Kombeve të Bashkuara, që është pikërisht nxitja dhe inkurajimi i respektimit universal dhe real i të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim race, seksi, gjuhe ose feje,

Duke marrë parasysh se Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut shpall se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet e në të drejta dhe se secili mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë që përmenden aty, pa asnjë dallim, sidomos lidhur me racën, ngjyrën ose prejardhjen kombëtare,

Duke marrë parasysh se të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim,

Duke marrë parasysh se Kombet e Bashkuara kanë dënuar kolonializmin dhe të gjitha praktikat e segregacionit dhe të diskriminimit që e shoqërojnë atë, në çdo formë dhe në çdo vend që mund të ekzistojnë, dhe se Deklarata për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë e datës 14 dhjetor 1960 (Rezoluta 1514 (XV) e Asamblesë së Përgjithshme), kanë theksuar dhe shpallur solemnisht domosdoshmërinë për t'i dhënë fund atij sa më parë dhe pa kushte,

Duke marrë parasysh se Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e datës 20 nëntor 1963 (Rezoluta 1904 (XVII) e Asamblesë së Përgjithshme) thekson solemnisht domosdoshmërinë e zhdukjes sa më të shpejtë të të gjitha formave dhe shfaqjeve të diskriminimit racial në të gjitha rajonet e botës si dhe të sigurimit kësajsoj të mirëkuptimit dhe respektimit të dinjitetit të njeriut,

Të bindur se çdo doktrinë epërsie e bazuar në diferencimin midis racave është shkencërisht e gabuar, moralisht e dëmshme, shoqërisht e padrejtë dhe e rrezikshme nga

pikëpamja shoqërore, dhe se nuk ekziston kurrfarë justifikimi për diskriminimin racial, askund, as në teori e as në praktikë,

Duke ritheksuar se diskriminimi midis njerëzve për arsye race, ngjyre ose prejardhjeje etnike është pengesë për marrëdhëniet miqësore e paqedashëse midis kombeve dhe mund të prish paqen dhe sigurinë midis popujve, si dhe bashkëjetesën e harmonishme midis personave të një shteti,

Të bindur se ekzistenca e barrierave raciste është e papajtueshme me idealet e çdo shoqërie njerëzore,

Të alarmuar nga shfaqjet e diskriminimit racial që ekzistojnë ende në disa rajone të botës, si dhe nga politika qeveritare e bazuar në epërsinë ose urrejtjen raciale, sikurse është politika e aparteidit, e segregacionit ose e ndarjes,

Të vendosur për të marrë të gjitha masat e nevojshme për zhdukjen e shpejtë të të gjitha formave dhe të të gjitha shfaqjeve të diskriminimit racial e për të parandaluar dhe luftuar doktrinat e praktikrat raciste për të ndihmuar mirëkuptimin midis racave dhe ndërtimin e një bashkësie ndërkombëtare të çliruar nga të gjitha format e segregacionit dhe të diskriminimit racial,

Duke pasur parasysh Konventën për Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe të Profesionit të cilën Organizata Ndërkombëtare e Punës e miratoi në vitin 1958 si dhe Konventën për Luftën Kundër Diskriminimit në Fushën e Arsimit të cilën Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e miratoi në vitin 1960,

Duke dëshiruar që t'i zbatojnë parimet e shpallura në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara si dhe të sigurojnë marrjen mundësisht sa më shpejtë të masave që të jetë e mundur marrjen e masave praktike për këtë qëllim,

U morën vesh për sa vijon:

PJESA E PARË

Neni 1

1. Shprehja “diskriminim racial”, në këtë Konventë, nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike.

2. Kjo Konventë vlen për me dallimet, kufizimet, përjashtimet ose preferencat e bëra nga një shtet palë i Konventës kur është fjala për shtetasit e vet dhe për ata të cilët janë shtetas të tij.

3. Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se cenon në çfarëdo mënyre dispozitat ligjore të shteteve palë lidhur me shtetësinë, qytetarinë, apo natyralizimin, me kusht që këto dispozita të mos jenë diskriminuese kundrejt ndonjë kombësie të veçantë.

4. Masat e veçanta që merren me të vetmin qëllim që të sigurojnë përparimin adekuat të një numri të konsiderueshëm të grupeve racore, etnike ose të individëve që kanë nevojë për mbrojtjen e nevojshme për të garantuar gëzimin dhe ushtrimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, në kushte barazie, nuk konsiderohen si masa diskriminimi racial, me kusht që këto masa të mos kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të veçanta për grupe racore të ndryshme dhe të mos mbeten në fuqi pasi të jenë arritur objektivat për të cilat janë marrë.

Neni 2

1. Shtetet palë dënojnë diskriminimin racial dhe zotohen të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë, një politikë të zhdukjes së çdo forme të diskriminimit racial dhe të ndihmojnë mirëkuptimin midis të gjitha racave. Për këtë qëllim:

(a) Çdo shtet palë zotohet se nuk do të kryejë asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit racial kundër personave, grupeve personash apo institucionesh dhe se do të sigurojë që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, t'i përmbahen këtij detyrimi;

(b) Çdo shtet palë zotohet se nuk do të inkurajojë, mbrojë apo mbështesë diskriminimin racial që zbatohet nga çfarëdo personi apo organizate;

(c) Çdo shtet palë duhet të marrë masa efektive për të rishikuar politikën qeveritare, kombëtare ose lokale, si dhe për të ndryshuar, shfuqizuar ose anuluar çdo ligj dhe çdo dispozitë që kanë për qëllim krijimin e diskriminimit racial apo përjetësimin e tij atje ku ekziston;

(ç) Çdo shtet palë duhet që, me të gjitha mjetet e përshtatshme, duke përfshirë, kur e kërkojnë rrethanat, edhe legjislacionin, të ndalojë diskriminimin racial që zbatohet nga çfarëdo personi, grupi personash apo organizate dhe t'i japë fund atij;

(d) Çdo shtet palë zotohet se do të përkrahë, në rast nevojë, organizatat dhe lëvizjet integracioniste shumëracione, dhe mjetet e tjera për t'i zhdukur barrierat midis racave, dhe për të shkurajuar çdo gjë që synon forcimin e përçarjes raciale.

2. Shtetet palë, po qe se e kërkojnë rrethanat, do të marrin masa të posaçme dhe konkrete në fushën sociale, ekonomike, kulturore dhe në fusha të tjera, për të siguruar zhvillimin dhe mbrojtjen adekuate të disa grupeve racore apo individëve që bëjnë pjesë në këto grupe me qëllim që t'u garantojnë atyre gëzimin e plotë dhe të barabartë të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Këto masa kurrsesi nuk duhet të kenë për pasojë ruajtjen e të drejtave të pabarabarta apo të veçanta për grupet e ndryshme racore pasi të jenë arritur objektivat që ato i kanë synuar.

Neni 3

Shtetet palë dënojnë veçanërisht segregacionin racial dhe aparteidin dhe zotohen të parandalojnë, të ndalojnë dhe të zhdukin të gjitha praktikatat e kësaj natyre në territoret e juridiksionit të tyre.

Neni 4

Shtetet palë dënojnë çdo propagandë dhe të gjitha organizatat të bazuara në idetë ose teoritë e epërsisë së një race apo të një grupi personash të një ngjyre apo origjine etnike të caktuar, ose të cilat përpiqen të justifikojnë atë e të ndihmojnë çdo formë të urrejtjes e të diskriminimit racial; ato zotohen të marrin masa të menjëhershme dhe pozitive për të zhdukur çdo nxitje për një diskriminim të tillë ose akt diskriminues dhe për këtë qëllim, duke mbajtur parasysh, si duhet, parimet e shprehura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e shpallura posaçërisht në nenin 5 të kësaj Konvente, ato zotohen konkretisht:

(a) Të shpallin vepra të dënueshme me ligj çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsinë ose urrejtjen raciale, çdo nxitje për diskriminim racial, si dhe çdo akt dhune, ose provokim për kryerjen e akteve të kësaj natyre kundër çdo race apo grupi personash të një ngjyre ose origjine tjetër etnike, si dhe ndihmën e veprimtarive raciste, duke përfshirë këtu edhe financimin e tyre;

(b) Të shpallin të paligjshme dhe të ndalojnë organizatat si dhe veprimtaritë propagandistike të organizuara e çdo aktivitet tjetër propagandistik që ndihmon dhe nxit diskriminimin racial dhe pjesëmarrjen në këto organizata dhe veprimtari të shpallin vepër të dënueshme me ligj;

(c) Të mos lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike, qofshin ato kombëtare ose lokale, që ndihmojnë diskriminimin racial apo ta nxisin atë.

Neni 5

Në përputhje me detyrimet themelore të parashtruara në nenin 2 të kësaj Konvente, shtetet palë zotohen të ndalojnë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave:

(a) E drejta e trajtimit të barabartë nga gjykatat ose nga çdo organ tjetër që administron drejtësinë;

(b) E drejta e sigurisë së personit dhe e mbrojtjes së tij nga shteti kundër dhunës dhe keqtrajtimeve qoftë nga funksionarët qeveritarë, qoftë nga ndonjë grup ose institucion i veçantë;

(c) Të drejtat politike, sidomos të drejtat e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, sipas sistemit të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, e pjesëmarrjes në qeveri si dhe në drejtimin e punëve shtetërore, në të gjitha nivelet, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike;

(ç) Të drejtat e tjera civile, sidomos:

i) E drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti;

ii) E drejta e largimit nga çdo vend, duke përfshirë edhe vendin e vet, dhe e rikthimit në vendin e vet;

iii) E drejta e një shtetësie;

iv) E drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit (bashkëshortes);

v) E drejta e çdo individi, qoftë i vetëm, qoftë në grup, për të pasur pronën e vet;

vi) E drejta e trashëgimisë;

vii) E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar;

viii) E drejta e lirisë së mendimit dhe fjalës;

ix) E drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore;

(d) Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore, sidomos:

(i) E drejta e punës, e zgjedhjes së lirë të punës, e gëzimit të kushteve të drejta dhe të kënaqshme pune për mbrojtje kundër papunësisë, pagë të barabartë, punë të barabartë, shpërblim të drejtë dhe të kënaqshëm;

(ii) E drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to;

(iii) E drejta e strehimit;

(iv) E drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale;

(v) E drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale;

(vi) E drejta e pjesëmarrjes së barabartë në veprimtari kulturore;

(dh) E drejta e hyrjes në të gjitha lokalet dhe shërbimet që janë në shfrytëzim të publikut, si mjetet e transportit, hotelet, restorantet, kafenetë, sallat e shfaqjeve dhe parqet.

Neni 6

Shtetet palë do t'i sigurojnë çdo personi që ndodhet nën juridiksionin e tyre mbrojtje dhe mjete juridike efektive nëpërmjet gjykatave kombëtare dhe institucioneve të tjera shtetërore kundër çdo veprimi të diskriminimit racial, i cili, në kundërshtim me këtë Konventë, do të shkelte të drejtat dhe liritë themelore si dhe të drejtën e kërkimit nga gjykatat e tilla dëmshpërblim adekuat dhe satisfaksion për çdo dëm që do t'i shkaktohej si rezultata i një diskriminimi të tillë.

Neni 7

Shtetet palë zotohen të marrin masa të menjëhershme dhe efektive sidomos në fushat e arsimit, edukimit, kulturës dhe informacionit për të luftuar kundër paragjykimeve që çojnë drejt diskriminimit racial dhe për të ndihmuar mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis kombeve dhe grupeve racore ose etnike, si dhe për të propaganduar qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, të Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe të kësaj Konvente.

PJESA E DYTË

Neni 8

1. Krijohet një Komitet për Eliminimin e Diskriminimit Racial (në tekstin e mëtejshëm: "Komiteti") i përbërë nga tetëmbëdhjetë ekspertë të njohur për moralin e tyre të lartë dhe për paanësinë e tyre. Këta ekspertë zgjedhen nga shtetet palë brenda shtetasve të tyre dhe

marrin pjesë në mbledhje në cilësi vetjake, duke pasur parasysh ndarjen gjeografike të drejtë dhe përfaqësimin e formave të ndryshme të qytetërimit, si dhe të sistemeve juridike kryesore.

2. Anëtarët e Komitetit zgjedhen me vota të fshehta nga një listë e kandidatëve të caktuar nga shtetet palë. Çdo shtet palë mund të caktojë një kandidat të zgjedhur midis shtetasve të vet.

3. Zgjedhja e parë do të bëhet gjashtë muaj pas ditës së hyrjes së kësaj Konvente në fuqi. Të paktën tre muaj para ditës së çdo zgjedhjeje, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara u dërgon letër shteteve palë në të cilën i fton t'i paraqesin kandidatët e tyre brenda një afati prej dy muajsh. Sekretari i Përgjithshëm përpilon një listë sipas rendit alfabetik me emrat e të gjithë kandidatëve të caktuar kështu, duke përmendur shtetet palë që i kanë caktuar dhe ua komunikon shteteve palë.

4. Anëtarët e Komitetit zgjedhen në një mbledhjeje të shteteve palë, të cilën e thërret Sekretari i Përgjithshëm në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këtë mbledhje, ku kuorumi përbëhet nga dy të tretat e shteteve palë, anëtarë të Komitetit zgjedhen kandidatët që fitojnë numrin më të madh të votave si dhe shumicën absolute të votave të përfaqësuesve të shteteve palë të pranishëm dhe që votojnë.

5. a) Anëtarët e Komitetit zgjedhen për katër vite. Megjithatë, mandati i nëntë anëtarëve që janë zgjedhur në zgjedhjet e para do të përfundojë pas dy vitesh. Kryetari i Komitetit do t'i caktojë me short emrat e këtyre nëntë anëtarëve menjëherë pas zgjedhjeve të para.

b) Për plotësimin e vendeve të lira të rastit shteti palë, eksperti i të cilit ka pushuar së ushtruar funksionin e vet si anëtar i Komitetit, emëron një ekspert tjetër nga shtetasit e tij, me kusht që këtë ta miratojë Komiteti.

6. Shtetet palë i heqin shpenzimet e anëtarëve të Komitetit për kohën kur ata kryejnë funksionet në Komitet.

Neni 9

1. Shtetet palë zotohen t'i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për shqyrtim nga Komiteti, një raport lidhur me masat e karakterit legjislativ, gjyqësor, administrativ dhe me masat që ato i kanë miratuar dhe që u japin efekt dispozitive të kësaj Konvente:

(a) Brenda një viti pas hyrjes së Konventës në fuqi për çdo shtet të interesuar për atë që i përket këtij dhe

(b) Pastaj në çdo dy vite dhe, kurdoherë, sa herë që Komiteti do ta kërkojë një gjë të tillë. Komiteti mund t'u kërkojë informacione plotësuese shteteve palë.

2. Komiteti i paraqet raport vjetor Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, lidhur me veprimtarinë e tij dhe mund të paraqesë sugjerime dhe rekomandime të bazuara në analizën e raporteve e të informacioneve që ka marrë nga shtetet palë. Këto sugjerime dhe rekomandime të përgjithshme ia bën të njohur Asamblesë së Përgjithshme së bashku me vërejtjet e shteteve palë, në qoftë se ekziston ndonjë.

Neni 10

1. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

2. Komiteti zgjedh byronë e vet për një kohë prej dy vitesh.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara siguron Sekretariatin e Komitetit.

4. Komiteti i mban zakonisht mbledhjet e tij në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 11

1. Nëse një shtet palë konsideron se ndonjë shtet tjetër palë nuk i zbaton dispozitat e kësaj Konvente, ai mund të tërheqë vëmendjen e Komitetit për këtë çështje. Komiteti ia transmeton atëherë njoftimin shtetit palë të interesuar. Brenda tre muajve, shteti që merr njoftimin i parashtron Komitetit shpjegime ose deklaratë me shkrim duke sqaruar çështjen dhe, në rastin konkret, tregon masat që mund të jenë marrë nga ky shtet për të rregulluar gjendjen.

2. Nëse brenda gjashtë muajve, nga data e marrjes së njoftimit origjinal nga shteti destinatar, gjendja nuk rregullohet në mënyrë të kënaqshme për të dyja shtetet, nëpërmjet bisedimeve dypalëshe ose në çdo procedurë tjetër të hapur për to, si njëri ashtu edhe shteti tjetër, ka të drejtë t'ia riparashtrojë çështjen Komitetit duke i dërguar një njoftim Komitetit dhe shtetit tjetër të interesuar.

3. Komiteti merret me çështjen që i parashtrohet sipas paragrafit 2 të këtij neni vetëm pasi të jetë siguruar që të gjitha mjetet e brendshme juridike të disponueshme janë përdorur ose konsumuar në këtë rast, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare të njohura përgjithësisht. Ky nuk duhet të jetë rregull nëse procedurat sipas mjetit juridik zgjaten tej afateve të arsyeshme.

4. Për çdo çështje që i paraqitet, Komiteti mund të kërkojë nga shtetet palë të interesuara t'i japin çdo informacion tjetër përkatës.

5. Kur Komiteti shqyrton një çështje, në përputhje me këtë nen, shtetet palë të interesuara kanë të drejtë të caktojnë një përfaqësues për të marrë pjesë në punimet e Komitetit pa të drejtë vote gjatë kohës sa zgjasin diskutimet.

Neni 12

1. (a) Kur Komiteti t'i ketë marrë dhe shqyrtuar të gjitha informacionet që i vlerëson të nevojshme, kryetari cakton një Komision *ad hoc* të pajtimit (në tekstin e mëtejshëm: "Komisioni"), të përbërë prej 5 vetash, të cilët mund të jenë ose jo anëtarë të Komitetit. Anëtarët e Komisionit caktohen me pëlqimin e njëzëshëm të palëve në mosmarrëveshje dhe shërbimet e tij vullnetmira u vëhen në dispozicion të shteteve të interesuara me qëllim që të arrihet një zgjidhje miqësore e problemit përkatës, bazuar në respektimin e kësaj Konvente.

(b) Në qoftë se shtetet palë në mosmarrëveshje nuk arrijnë të merren vesh brenda tre muajve për tërë apo për një pjesë të përbërjes së Komisionit, anëtarët e Komisionit që nuk marrin pëlqimin e shteteve palë në mosmarrëveshje, zgjedhen me votim të fshehtë midis anëtarëve të Komitetit me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të Komitetit.

2. Anëtarët e Komisionit marrin pjesë në mbledhje në cilësi vetjake. Ata nuk duhet të jenë shtetas të njërit prej shteteve palë në mosmarrëveshje e as të një shteti që nuk është palë e kësaj Konvente.

3. Komisioni zgjedh kryetarin dhe harton rregulloren e vet të brendshme.

4. Komisioni zhvillon punimet zakonisht në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose në çdo vend tjetër të përshtatshëm që e cakton Komisioni.

5. Sekretariati i siguar në përputhje me nenin 10, paragrafi 3, të kësaj Konvente, gjithashtu ndihmon Komisionin me shërbimet e veta sa herë që ndonjë mosmarrëveshje midis shteteve palë bëhet shkak për formimin e Komisionit.

6. Të gjitha shpenzimet e anëtarëve të Komisionit ndahen në mënyrë të barabartë midis shteteve palë në mosmarrëveshje, në përputhje me preventivin e siguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

7. Sekretari i Përgjithshëm është i autorizuar, po të jetë nevoja, që anëtarëve të Komisionit t'u paguajë shpenzimet para se shtetet palë në mosmarrëveshje t'i kenë kompensuar, në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni.

8. Informacionet që ka marrë dhe shqyrtuar Komiteti vëhen në dispozicion të Komisionit dhe Komisioni mund të kërkojë që shtetet e interesuara të japin çdo sqarim plotësues përkatës.

Neni 13

1. Pasi ka shqyrtuar çështjen në të gjitha aspektet e saj, Komisioni përgatit dhe i paraqet kryetarit të Komitetit një raport me konkluzionet lidhur me të gjitha çështjet konkrete që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjen midis palëve, ku përmbahen rekomandimet që Komisioni i quan të përshtatshme për arritjen e një zgjidhjeje miqësore të mosmarrëveshjes.

2. Kryetari i Komitetit ia kumton raportin e Komisionit secilit shtet palë në mosmarrëveshje. Këto shtete njoftojnë kryetarin e Komitetit brenda 3 muajve, nëse i pranojnë ose jo rekomandimet që përmbahen në raportin e Komisionit.

3. Pasi të mbarojë afati i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, kryetari i Komitetit ua kumton raportin e Komisionit dhe deklaratat e shteteve palë të interesuara shteteve të tjera palë të kësaj Konvente.

Neni 14

1. Një shtet palë mund të deklarojë kurdoherë se njeh kompetencën e Komitetit për të marrë dhe shqyrtuar kumtesa të personave ose grupeve të personave të juridiksionit të tij, ku këta pohojnë se janë viktima të një shkeljeje, nga ana e këtij shteti palë, të njërës prej të drejtave që përmban kjo Konventë. Komiteti nuk pranon asnjë kumtesë që ka të bëjë me një shtet palë që nuk e ka dhënë një deklaratë të tillë.

2. Çdo shtet palë që jep një deklaratë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, mund të krijojë ose të caktojë një organ brenda rendit të vet juridik kombëtar, i cili do të jetë kompetent për të marrë dhe shqyrtuar peticionet nga individët apo grupe individësh që janë nën juridiksionin e shtetit në fjalë, të cilët pohojnë se janë viktima të një shkeljeje të cilësdo të drejte të përfshirë në këtë Konventë, pasi të kenë përdorur mjetet e tjera juridike në dispozicion.

3. Deklarata e bërë në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe emri i çdo organi të themeluar apo caktuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni depozitohen nga shteti palë i interesuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili u kalon një kopje të saj shteteve të tjera palë. Deklarata mund të tërhiqet kurdoherë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, por kjo tërheqje nuk prek kumtesat që i janë bërë më parë Komitetit.

4. Organi i themeluar ose i caktuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni duhet të mbajë një regjistër me peticionet dhe kopjet e vërtetuara të regjistrit i depozitohen një herë në vit Sekretarit të Përgjithshëm në kanalet e përshtatshme, me rezervën që përmbajtja e këtyre kopjeve nuk do t'i bëhet e njohur publikut.

5. Në qoftë se nuk merr pëlqimin e organit të themeluar ose të caktuar në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni paraqitësi i peticionit ka të drejtë t'i drejtojë një kërkesë brenda një afati prej gjashtë muajsh Komitetit lidhur me këtë çështje.

6. a) Komiteti, duke ruajtur fshehtësinë, e njofton shtetin palë për të cilin mendohet se ka shkelur një nga dispozitat e Konventës, lidhur me çdo kumtesë që i drejtohet por në këtë rast identiteti i personit apo i personave të interesuar nuk duhet të tregohet pa pëlqimin e posaçëm të personit në fjalë apo të grupit të personave përkatës. Komiteti nuk pranon kërkesë anonime;

(b) Brenda tre muajve, shteti në fjalë i paraqet Komitetit shpjegime ose deklarata sqaruese me shkrim të çështjes ku gjithashtu flet, në rastin konkret, edhe për masat që mund të ketë marrë për të zgjidhur problemin.

7. a) Komiteti shqyrton kërkesat duke pasur parasysh të gjitha informacionet të cilat ia kanë paraqitur shteti palë i interesuar si dhe paraqitësi i peticionit. Komiteti nuk ka për të shqyrtuar asnjë kërkesë pa u siguruar më parë se janë konsumuar të gjitha mjetet e brendshme juridike në dispozicion. Megjithatë, ky rregull nuk zbatohet në rast se zbatimi i mjeteve juridike kalon afatet e arsyeshme;

(b). Komiteti u dërgon sugjerimet dhe rekomandimet e veta eventuale si shtetit palë të interesuar ashtu edhe paraqitësit të peticionit.

8. Komiteti ia bashkëngjet raportit të vet vjetor një përmbledhje të këtyre kumtesave dhe, po qe e nevojshme, një përmbledhje të shpjegimeve dhe deklaratave të shteteve palë të interesuara, si dhe të sugjerimeve dhe rekomandimeve të veta.

9. Komiteti ka kompetencë të ushtrojë funksionet e parashikuara në këtë nen vetëm kur të paktën 10 shtete palë të Konventës janë të lidhura me deklarata të bëra në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 15

1. Në pritje të arritjes së synimeve të Deklaratës për Dhënien e Pavarësisë Vendeve dhe Popujve Kolonialë, që përmbahen në Rezolutën 1514 (XV) të Asamblesë se

Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të datës 14 dhjetor 1960, dispozitat e kësaj Konvente nuk e kufizojnë aspak të drejtën e peticionit që u është dhënë këtyre popujve nga ana e instrumenteve të tjera ndërkombëtare ose nga Organizata e Kombeve të Bashkuara apo institucionet e saj të specializuara.

2. a) Komiteti i krijuar në përputhje me nenin 8, paragrafin 1 të kësaj Konvente merr kopje të peticioneve nga organet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, që merren me çështjet që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me parimet dhe objektivat e kësaj konvente, shpreh mendimin dhe bën rekomandime lidhur me peticionin që ka marrë gjatë shqyrtimit të peticioneve të ardhura nga banorët e territoreve që janë nën kujdestari ose të territoreve jovetëqeverisëse, si dhe të çdo territori tjetër për të cilin aplikohet Rezoluta 1514 (XV) e Asamblesë së Përgjithshme, dhe që kanë të bëjnë me çështjet që synon kjo Konventë, çështje që u shtrohen për shqyrtim këtyre organeve;

(b) Komiteti merr nga organet kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kopje të raporteve që flasin për masat legjislative, gjyqësore, administrative ose të tjera, të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me parimet dhe objektivat e kësaj Konvente, që fuqitë administrative i kanë zbatuar në territoret e përmendura në nënparagrafin (a) të këtij neni. Po ashtu ai u jep mendime dhe rekomandime këtyre organeve.

3. Komiteti u bashkëngjet raporteve të tij për Asamblenë e Përgjithshme një përmbledhje të peticioneve dhe të raporteve që ka marrë nga organet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe mendimet e rekomandimet që ka bërë duke u mbështetur peticionet dhe raportet e sipërpërmendura.

4. Komiteti i dërgon lutje Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara që t'ia dorëzojë çdo informacion që ka të bëjë me objektivat e kësaj Konvente dhe që i disponon lidhur me territoret e përmendura në paragrafin 2 (a) të këtij neni.

Neni 16

Dispozitat e kësaj Konvente që kanë të bëjnë me masat që duhen marrë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje apo të një ankese, janë të zbatueshme pa i dëmtuar procedurat e tjera të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ose ankesave në fushën e diskriminimit, të cilat parashikohen në instrumentet përbërëse të Kombeve të Bashkuara, dhe të organizatave të tyre të specializuara ose në Konventat e miratuara nga këta organizma, dhe nuk i pengojnë shtetet palë të përdorin procedura të tjera për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të përgjithshme ose të veçanta që i lidhin midis tyre.

PJESA E TRETË

Neni 17

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e çdo shteti anëtar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose anëtar i njërit prej organizatave të saj të specializuara, e çdo shteti palë të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, si dhe të çdo shteti që ftohet nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për t'u bërë palë të kësaj Konvente.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

1. Kjo Konventë është e hapur për aderimin e çdo shteti që përmendet në nenin 17, paragrafin 1 të Konventës.

2. Aderimi kryhet duke depozituar një instrument të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 19

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e tridhjetë pas ditës së depozitimit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të instrumentit të njëzeteshtatë të ratifikimit ose të aderimit.

2. Për çdo shtet që do të ratifikojë këtë Konventë apo që do të aderojë në të pas depozitimit të instrumentit të njëzeteshtatë të ratifikimit ose të aderimit, Konventa në fjalë hyn në fuqi ditën e 30-të pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të tij të ratifikimit ose të aderimit.

Neni 20

1. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara merr dhe u komunikon të gjitha shteteve, që janë ose që mund të bëhen palë të kësaj Konvente, rezervat që mund të jenë shprehur në çastin e ratifikimit apo të aderimit. Çdo shtet që ka vërejtje ndaj rezervës lajmëron Sekretarin e Përgjithshëm, brenda 90 ditësh nga data e njoftimit përkatës, se nuk e pranon rezervën në fjalë.

2. Rezerva që nuk pajtohet me objektin dhe qëllimin e kësaj Konvente nuk lejohet, ndërsa rezerva e cila do të kishte për efekt paralizimin e funksionimit të çdonjërit prej

organeve të themeluara nga Konventa nuk pranohet. Një rezervë do të konsiderohet se hyn në kategoritë e përcaktuara më sipër në rast se të paktën dy të tretat e shteteve palë të Konventës kanë kundërshtim ndaj saj.

3. Rezervat e shprehura mund të tërhiqen kurdoherë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Njoftimi do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së tij.

Neni 21

Një shtet palë mund ta denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Denoncimi hyn në fuqi një vit pas ditës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë shteteve palë lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente, që nuk është zgjidhur përmes bisedimeve ose procedurave posaçërisht të parashikuara në këtë Konventë, i kalohet për vendim Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesën e secilës palë në mosmarrëveshje, përveç kur palët në mosmarrëveshje pajtohen për një mënyrë tjetër të zgjidhjes se saj.

Neni 23

1. Çdo shtet palë mund të formulojë kurdoherë një kërkesë për rishikimin e kësaj Konvente nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara vendos për masat që duhen marrë, në rast se është e nevojshme lidhur me një kërkesë të tillë.

Neni 24

Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara i njofton të gjitha shtetet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 17 të kësaj Konvente:

(a) Lidhur me nënshkrimet që janë vërë në tekstin e kësaj Konvente dhe me instrumentet e ratifikimit dhe të aderimit të dorëzuar në përputhje me nenet 17 dhe 18;

(b) Lidhur me datën kur kjo Konventë do të hyjë në fuqi në përputhje me nenin 19;

(c) Lidhur me njoftimet dhe me deklaratat që janë marrë në përputhje me nenet 14, 20 dhe 23;

(ç) Lidhur me denoncimet e bëra në përputhje me nenin 21.

Neni 25

1. Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhët kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle janë njësoj autentike, do të depozitohet në arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'u dorëzojë një kopje të vërtetuar të kësaj Konvente të gjitha shteteve që bëjnë pjesë në njërin nga kategoritë e përmendura në nenin 17, paragrafin 1 të Konventës.